



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE
SEKTORI I ASISTENCËS DHE SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESIT**

Nr. 3693 Prot.

Tiranë, më 15.2.2019

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Ilia BOSTANXHIU

Shoqëria "OI-VAHROM" Shpk

Rruga "Dibrës" nr. 403 , Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 15.02.2019, protokolluar me nr.3693 Prot., datë 18.02.2019 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 106, në të cilën kërkon informacion për deklarimin në librat e blerjes të disa faturave tatimore, nga një subjekt tjetër tatimpagues, ju informojmë sa më poshtë vijon:

Neni 3/1 i Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", parashikon shprehimisht se: *"çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet"* dhe më tej, pika 3, e të njëjtit nen parashikon se: *"çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit."*

E drejta për informim, gjithashtu, është një e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Neni 23/2, i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton se: *"Kushdo ka të drejtë, në përputhje me Ligjin të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore."*

Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj, rezulton se nuk jemi në kushtet e parashikuara më sipër, pasi informacioni i kërkuar nga ju, nuk është informacion publik lidhur me veprimtarinë e administratës tatimore, por ka të bëjë me dhënat tatimore të një tatimpaguesi tjetër.

ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM

XHAVIT ÇURRI